



Instituti i Kërkimeve Urbane

**HARTIMI I OBJEKTIVAVE TE OZHM PER FURNIZIMIN ME UJE DHE  
KANALIZIMET SI DHE TREGUESIT PER KUSHTET LOKALE NE ECA  
(GJEORGJI, TAXHIKISTAN, SHQIPËRI)**

Kjo gjendje ndikohet kryesisht nga niveli i larte i dëmtimeve në infrastrukturë, rezultati i të cilave është humbja e madhe e ujit dhe shpesh shoqerohet me përzierjen me ujrat e zeza, duke shkaktuar kështu ndotjen e ujit të pijshem. Investimet nevojiten në të dy sektoret, si në ujin e pijshëm ashtu edhe në kanalizimet e ujrave të zeza për 10 vitet në vazhdim, në mënyre që të arrihen standartet e BE, llogariten tek 150-170 Milion dollare amerikanë, të paktën tre herë më shumë nga ç'është financuar deri tani. Situata është rënduar edhe si pasoje e ndërhyrjeve ilegale në rrjet, si pasojë e migrimit të pakontrolluar nga zonat rurale në ato urbane.

Objektivi i shtatë “Sigurimi i pandërprerë mjedisor” i Deklarates së Mijevjeçarit- përfshin objektivin 10, i cili parashikon “përgjysmimin, deri në 2015, e raportit të njerëzve pa mundësi për ujë të pijshëm të vazhdueshëm dhe kanalizime qendrore”. Dy treguesit e strukture zyrtare globale, respektivisht 30 dhe 31, u projektuan për të matur zhvillimin në drejtim të objektivit 10 sipas Programit të Përbashkët të Monitorimit duke përfshirë vendet pilot të Gjeorgjisë, Taxhikistanit dhe Shqipërisë. Ky studim ofron kapitulline matjeve globale në këtë sektor për Shqipërinë.

Aktualisht ka 30 kompani për ujin e pijshëm dhe kanalizimet e ujrave të zeza dhe 24 kompani që manaxhojnë vetëm ujin e pijshëm, pra 54 kompani që ofrojnë shërbimin për 65 bashki dhe për disa fshatra në 171 komuna. Ky studim synoi realizimin e një analize të nevojave për një zhvillim të pandërprerë të kapacitetit kombëtar të statistikave dhe sistemit të monitorimit të zhvillimit, duke përdorur një strukturë globale dhe një grup treguesish plotësues në shtetet pilote të Gjeorgjisë, Taxhikistanit dhe Shqipërisë.

Produkti kryesor është një raport analitik dhe i mirëstrukturuar, që përmban tre kapituj kryesorë.

1. Studim analitik treguesish, që shpjegon treguesit plotësues dhe metodën për prezantimin e tyre, bashkë me treguesit e strukture globale.
2. Të dhënat analitike për vendin, që përfshijnë: Vlerësimin e cilësisë dhe përdorshmërisë së të dhënave; mbledhjen e të dhënave për strukturën globale dhe treguesit plotësues; përcaktimin e të dhënave bazë; itinerarin e pëlqyeshëm të OZHM (Objektivat e Zhvillimit për Mijevjeçarit).
3. Analiza e kostove dhe institucioneve të Shqipërisë për krijimin e një sistemi statistikor të besueshëm për monitorimin e treguesve plotësues.